

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin Ilir Bytyqi dhe me sekretaren ligjore Mimoza Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.B. nga Ferizajt, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par. 6 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2167-2/13 e dt.29.05.2014, pas mbajtjes së seancë së shqyrtimit fillestar publik, në praninë e përfaqësuesit të akuzës – prokurorit, Visar Musa, përf. me autorizim i familjes së të dëmtuarve Av. A.L., të dëmtuarit D.N., të akuzuarit M.B. me përf. me autorizim Av. A.I., me dt. 27 Maj 2016 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me dt. 06 Qershor 2016 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari M.B. data e lindjes në Ferizaj, nga i ati U. dhe e ëma B. e gjinisë M. me vendbanim në Rr. '.....' pn. (Pas MOB-in) në Ferizajt, i gjendjes së mesme ekonomike, ka te kryer shkollën fillore, me profesion autolimar, i papunë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 26.10.2013, rreth orës 07:00, në magjistralen Kaçanik-Ferizaj, përkatësisht përball ish kampit të Kforit Grek, në Fsh. Komogllavë K. Ferizaj, duke drejtuar automjetin e markës 'Landrover Freelander' me targa të regjistrimit, duke lëvizur nga Kaçaniku në drejtim të Ferizajt, e duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 49/1 të LSKRR-së, nga pakujdesia, duke mos qenë i kujdesshëm sa duhet dhe nuk ka mbajtur shiritin e vetë të lëvizjes kalon në shiritin e kundërt të lëvizjes dhe me pjesën e përparme të automjetit e godet automjetin kombi të markës 'Volkswagen Furgon', me targë të regjistrimit, të cilin e drejtonte A.C. nga Prishtina, i cili nga

lëndimet e marra në këtë aksident ndërron jetë në QKUK në Prishtinë të njejtën ditë në ora 16:30, në këtë aksident lëndime të rënda trupore pëson D.N. nga Ferizaj.

me të cilën ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par. 6 të KPRK-së.

Andaj, në bazë nenit 378 dhe neneve 4, 7, 17, 23, 41, 42, 43, 45, 73, 74, 75, 76 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPK-së,

G J Y K O N

- ME DËNIM BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 9/nëntë/ Muaj, të cilin dënim do ta vuaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.
- Të dëmtuarit, H.C., E.C., J.C., K.C.1, Sh.C., K.C.2 dhe D.N. për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.
- Në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale (në emër të ekspertizës së komunikacionit dhe ekspertizën mjeko-ligjore) të paguaj shumën prej 51.10 € /pesëdhjetë e një euro e dhjetë cent/, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 € në afat prej 30 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin të ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën të evidentuar si PP.nr.2167-2/13 e dt.29.05.2014, ka ngarkuar të akuzuarin M.B., për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par.6 të KPRK-së, ku në shqyrtimin fillestar publik ka mbetur në tërësi pranë aktit akuzues, duke kërkuar që të pandehurit të shpallet fajtorë dhe të ju shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar të pandehurit gjykohet nga gjyqtari individual.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 27 Maj 2016, në të cilën shqyrtim fillestar i akuzuari është deklaruar: fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza, duke e shprehur pendimin të thellë për veprën penale të kryer, nuk kam pasur qëllim që të shkaktohet ky aksident, ku edhe vetë jam i lënduar, dhe poashtu nuk kam dëshiruar humbjen e një personi, andaj i kërkoj falje publike familjes së të dëmtuarve si dhe duke i falënderuar për mbështetjen e dhënë, pasi që ky aksident është shkaktuar nga pakujdesia, duke e lutur Gjykatën që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Përf. me Autorizim i të pandehurit Av.A.I. duke shprehur mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, vlerëson se pranimi i fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij është bërë në mënyrë vullnetare, tregon pendimin e thellë për veprën penale të cilën e ka kryer, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë për faktin se edhe i pandehuri ka pësuar lëndime shumë të rënda në atë aksident, për të cilat ishte i palëvizshëm, ishte i moshës së re, duke i propozuar Gjykatës që ti ketë parasysh këto rrethana dhe të pandehurit ti shqiptoj një sanksion penal sa më të butë.

Prokurori i Shtetit Visar Musa, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që gjatë matjes së denimit ti ketë parasysh si rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe ti shqiptoj një sanksion penal të paraparë me ligj

Përf. me Autorizim i familjes së të dëmtuar Av.A.L. duke shprehur mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se në emër të familjes së të ndjerit nuk i

bashkëngjitëm ndjekjes penale, për arsye se i pandehuri ka kërkuar falje dhe për faktin se ky aksident ka ndodhur nga pakujdesia, ndërsa kërkesën pasurore juridike do ta paraqesim në procedurë juridiko-civile.

I dëmtuari D.N. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe kërkesën pasurore juridike do ta parashtrijë në procedurë juridiko-civile

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 të KPP-së dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarit gjatë procedurës penale, Ekspertiza mjeko-ligjore dt.09.05.2014, Ekspertiza e inxhinierit të komunikacionit e dt.13.12.2013, fletë vdekja me Epikrizë e QKUK-së Klinika e Anestilogjisë dhe mjekimit Intensiv me nr. rendor/2013 e dt.26.10.2013 për të ndjerin A.C., Vërtetimi për vdekjen nga e njëjta klinikë e dt.26.10.2013, Raporti i Aksidentit 2013-CFT-.... e dt.26.10.2013, deklarata e të pandehurit M.B. e dt.27.11.2013, si dhe fotografit të cilat gjenden në shkresat e lendes, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;
- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par.6 të KPRK-së, meqë i akuzuari në vend, datë dhe kohë e përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi, duke drejtuar automjetin e markës 'Landrover Freelander' me targa të regjistrimit, duke lëvizur nga Kaçaniku në drejtim të Ferizajt, e duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 49/1 të LSKRR-së, nga pakujdesia, duke mos qenë i kujdesshëm sa duhet dhe nuk ka mbajtur shiritin e vetë të lëvizjes kalon në shiritin e kundërt të

lëvizjes dhe me pjesën e përparme të automjetit e godet automjetin kombi të markës ‘Volkswagen Furgon’, me targë të regjistrimit, të cilin e drejtonte A.C. nga Prishtina, i cili nga lëndimet e marra në këtë aksident ndërron jetë në QKUK në Prishtinë të njejtën ditë në ora 16:30, në këtë aksident lëndime të rënda trupore pëson D.N. nga Ferizaj.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj trupi gjykues konform nenit 248 paragrafit 4 të KPP-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, (nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73,74 dhe 75 të KPK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë në shqyrtimin gjyqësor, kurse si rrethana lehtësuese, pendimin e singhtë dhe real për veprën penale të kryer, i moshës e re, faktin se me familjen e të dëmtuarve është pajtuar sipas traditave tona, më parë nuk ka qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë kurse në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale që për pasojë ka marrë jetën e një personi.

Gjykata është e bindur se edhe me aplikimin e institutit të zbutjes së dënimit, në kuptim të nenit 75 dhe 76 të KPRK-së, edhe me anë të këtij dënimi (nën minimumin e përcaktuar ligjor) është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, duke u nisur nga fakti se i akuzuari ka pranuar fajësinë dhe me këtë dënim që është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, rrethanat e kryerjes, se edhe me anë të këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjeneralë).

Gjykata, Të dëmtuarit, H.C., E.C., J.C., K.C.1, Sh.C., K.C.2 dhe D.N. për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

Në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale (në emër të ekspertizës së komunikacionit dhe ekspertizën mjeko-ligjore) të paguaj shumën prej 51.10 € /pesëdhjetë e një euro e 10 dhjetë cent/, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 € në afat prej 30 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin të ekzekutimit me dhunë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIAJ

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,

P.nr.591/14 e dt.06.06.2016

**Sekretarja Juridike,
Mimoza Shabani**

**Gjyqtari Individual,
Ilir BYTYQI**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.